



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DHE EKONOMISË

## **Pagat e administratës publike rriten 10%, një tjetër shpërblim i reformave të suksesshme!**

2017-03-08 10:44:00



***"Rritja e pagave dhe pensioneve, një premtim i mbajtur falë suksesit të reformave! Në mandatin e dytë, punësimi dhe mirëqenia e qytetarëve, prioritet kryesor!"***

Përsëhendetje,

Sot Këshilli i Ministrave kaloi VKM për rritjen e pagave në administratën publike. Nga sot rritja 10% e pagës është realitet dhe premtim i mbajtur i qeverisë Rama, pas rritjes së pensioneve në 1 mars, duke angazhuar fondin më të madh në 25 vjet të akorduar në buxhetin e shtetit për rritjen e pagave dhe pensioneve.

### **Duke filluar nga sot, është jetësuar rritja e pagave mesatarisht 10% për:**

**1. Punonjësit e administratës publike - Nëpunësit civilë/ nëpunësit, zv.ministrat, aparatet e ministrave të linjës, administratën e Presidentit, Administratën e Kuvendit, KQZ, Gjykatën e Lartë Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucione në varësi të Kryeministrit, ministrave të linjës dhe administratën e prefektit.**

Në total janë rreth 21 mijë punonjës që përfitojnë rritjen e pagës nga kategoria e mësiperme, me një kosto financiar vjetore 1 miliardë lekë.

**2. Në të njëjtën kohë, sot është njëjtësuar rritja e pagave për punonjësit në arsimin parauniversitar. Rritja e pagave për punonjësit në arsimin parauniversitar është 10%.**

- Paga bazë e mësuesit në shkollat e mesme rritet me 3 850 lekë/muaj dhe Paga Bruto shkon 68 150 lekë/muaj
- Paga bazë e mësuesit në ciklin e lartë në shkollat 9-vjeçare rritet me 3 550 lekë/muaj dhe Paga Bruto shkon 64 650 lekë/muaj
- Paga bazë e mësuesit në ciklin e ulët në shkollat 9-vjeçare rritet me 3 350 lekë/muaj dhe Paga Bruto shkon 62 450 lekë/muaj

Nga ky vendim përfitojnë 31,370 punonjës të sistemit arsimor, me efekt vjetor 1.3 miliardë lekë.

**3. Gjithashtu, paga në këtë sistem shoqërohet edhe me rritjen e pagave në sistemin arsimor të lartë me 10-12%.** Janë rreth 3500 profesorë dhe punonjës akademikë, të cilëve iu rritet paga pas një periudhe shumë të gjatë e paprekur nga asnjë qeveri, me një fond 45 milionë në vit.

**4. Rritjen e pagave me 10% në sistemin shëndetësor.**

Përfitojnë 18 mijë nëpunës me një fond total prej 1.3 miliardë lekë në 12 muaj.

**5. Në të njëjtën kohë rritjen me 10% të pagës për të gjitha gradat diplomatike.** Në total, numri - përfituesve nga ky vendim është rreth 400 punonjës te Ambasadave me efekt financiar 70 milionë lekë (12 mujor)

**6. Rritje me 7% e pagës për administratën në njësitë e pushtetit vendor.** Kjo rritje për punonjësit e administratës së pushtetit lokal do të përballohet nga të ardhurat e vetë njësitë

vendore.

Dua ta mbyll duke theksuar se vendimi i sotem është një shprehje e drejtpërdrejtë e një realiteti të ri, të patjetërsueshëm në të cilin ka hyrë vendi si rezultat i reformave të vështira por të suksesshme të ndërmarra në tre vjet e gjysëm; si rezultat po ashtu i konsolidimit të rritjes ekonomike, si rezultat i reflektimit të zhvillimit ekonomik por edhe si shprehje e mbështetjes dhe patjetër e mirënjohjes sonë si qeveri, për kontributin që këta nëpunës të administratës shtetërore kanë dhënë në jetësimin e reformave, pa të cilët nuk do t'ia kishim dalë të jemi sot këtu ku jemi.

Rritja e pagave, ashtu si dhe ajo e pensioneve është një shprehje e drejtpërdrejtë e solidarizimit të qeverisë me të gjithë ata që në njërin anë nuk janë prekur njëlloj nga rritja ekonomike, në anën tjetër të nëpunësve që kanë mbajtur në shpatulla barrën e reformave të vështira, por të domosdoshme për vendin.

Rritja e pagave dhe pensioneve një premtim i qeverisë Rama, sot është realiteti i reformave.

Ka akoma shumë për të bërë, sidomos me një reforme të domosdoshme për të na shtyrë përpara. Është Reforma në Drejtësi, Vettingu, i cili do të bëjë të mundur një zhvillim ekonomik akoma më të madh, një platformë e një drejtësie që do të japë drejtësi dhe që do të zhvillojë punësimin nëpërmjet tërheqjes së investimeve të huaja, investimeve të vendit, por edhe dhënies së vendit një imazh që vendi jonë padyshim e meriton.

Sigurisht që kemi ende akoma për të bërë. Në mandatin e dytë, punësimi dhe mireqenia e qytetarëve do të vazhdojnë të jenë prioriteti ynë në qeveri dhe bashkë me të, edhe rritja e mëtejshme e pagave dhe pensioneve, për të bërë të mundur që efektet e zhvillimit ekonomik të vendit, të shtrihen, të preken dhe të jetojnë në çdo cep të Shqipërisë, nga çdo familje dhe qytetar.

Në fund dua të uroj, zonjat, nënat, motrat, Gëzuar 8-marsin. Për shumë prej tyre në administratë, sistemin shëndetësor apo arsimor, sot janë dy gëzime në një ditë, për ata që përfitojnë nga rritja e pagave dhe pensioneve.

Faleminderit!